



BASHKIA E TIRANËS
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË

V E N D I M

Nr. 1 datë 26.02.2014

PËR
“MIRATIMIN E PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM 2014-2016 DHE
DETAJIMIN E BUXHETIT TË BASHKISË SË TIRANËS PËR VITIN 2014”

Në mbështetje të nenit 7 pika 2, nenit 19 pikat 1-8 dhe nenit 32, gërma “dh” të ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 për “Organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” (i ndryshuar); ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 për “Menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar); ligjit nr.7776, datë 22.12.1993 për “Buxhetin lokal” (i ndryshuar); udhëzimit të Ministrit të Financave nr.8, datë 29.03.2012, për “Procedurat standarde të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm”, udhëzimit 9/1, datë 25.2.2013 për “Përgatitjen e buxhetit vendor”, me propozim të Kryetarit të Bashkisë së Tiranës, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I:

1. Të miratojë Programin Buxhetor Afatmesëm të Bashkisë së Tiranës për periudhën 2014-2016 si më poshtë vijon.

1.1 Plani i të ardhurave të Bashkisë së Tiranës për periudhën 2014-2016, është në shumat si më poshtë:

Plani i të ardhurave	Në lekë		
	2014	2015	2016
Të ardhura nga taksat dhe tarifat vendore	6.892.530.000	7.098.182.000	7.233.247.000
- Të ardhura tatimore	4.854.947.000	4.990.282.000	5.054.277.000
- Të ardhura jo tatimore	2.037.583.000	2.107.900.000	2.178.970.000
Të ardhura të trashëguara	338.920.000	250.000.000	250.000.000
Të ardhura nga transferta e pakushtëzuar	1.187.821.807	1.223.456.461	1.260.160.155
Totali	8.419.271.807	8.571.638.461	8.743.407.155

1.2 Plani i shpenzimeve të Bashkisë së Tiranës Tiranës për periudhën 2014-2016, është në shumat si më poshtë:

Plani i shpenzimeve	Në lekë		
	2014	2015	2016
Shpenzime korrente	5.581.606.807	5.280.780.461	5.483.549.155
Shpenzime kapitale	2.837.665.000	3.290.858.000	3.259.858.000
Totali	8.419.271.807	8.571.638.461	8.743.407.155

2. Të miratojë detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2014 si më poshtë:
 - 2.1 Të miratojë planin e të ardhurave të Bashkisë së Tiranës sipas Pasqyrës Nr.1, pjesë përbërëse të këtij vendimi.
 - 2.2 Të miratojë numrin e punonjësve të Bashkisë së Tiranës, Njësi Bashkiake si dhe çdo institucioni dhe ndërmarrje të varësisë sipas pasqyrës Nr.2, pjesë përbërëse e këtij vendimi.
 - 2.3 Të miratojë detajimin e buxhetit të shpenzimeve të Bashkisë së Tiranës sipas Pasqyrave Nr.3, Nr.3/1 dhe 3/2-a,b pjesë përbërëse të këtij vendimi.
 - 2.4 Të miratojë planin e shpenzimeve kapitale sipas programeve si në Pasqyrën Nr.4 pjesë përbërëse të këtij vendimi.
 - 2.5 Ngarkohet Drejtoria e Planifikimit Strategjik të kryejë avancim të fondeve mujore sipas realizimit të të ardhurave për vitin 2014.

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Planifikimit Strategjik, Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Menaxhimit të Shërbimeve, Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Drejtoria e Përgjithshme e Politikave të Zhvillimit dhe Promovimit të Qytetit, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Mbështetëse, Drejtoria e Përgjithshme e Projekteve Strategjike dhe Investimeve të Huaja, Drejtoria e Prokurimeve, Njësitë Bashkiake dhe të gjitha Institucionet dhe Ndërmarrjet në varësi të Bashkisë së Tiranës.

4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes.

K R Y E T A R

ALDRIN DALIPI